



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni i Veçante

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401406/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda : *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisarariat Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë*

Drejtuar : **Drejtorit të Policisë së Qarkut
Z. Ardian ÇIPA**

Tiranë

**Shefit të Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore
Z. Besmir QIBINI**

Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet se:

"Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise.

Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet", në datën 02.10.2014 nga ora 11.00 - 13.00 inspektoi Komisarariat Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë.

Grupi i inspektimit përbëhej nga Nd/komisionerët e Seksionit të Veçantë Sotiraq Nushi dhe Hajredin Hysa.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të të drejtave të qytetarëve që paraqiten në këto organe për probleme të ndryshme, si ankesa, kërkesa etj; zbatimin e procedurave ligjore për njoftimin e qytetarëve (pronarëve të mjeteve) ndaj të cilëve janë vendosur gjoba administrative në mungesë; sjelljen e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët.

Grupi i inspektimit mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës nga Shefi i Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, nga punonjësit e policisë që u

shërbenin qytetarëve, nga disa qytetarë që u gjendën aty, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës.

Zbatimi i procedurave ligjore nga Komisariati Rajonal i Policisë Rrugore Tiranë për njoftimin e qytetarëve ndaj të cilëve janë vendosur gjoba në mungesë:

Nga ky komisarjat ishte hapur dhe administrohej “Regjistri i njoftimeve për gjobat jo prezent”. Njoftimi i kundërvajtësve jo prezent bëhej nëpërmjet Postës Shqiptare. Punonjësit e sektorit të kartotekës na informuan se rreth 85% e njoftimeve ktheheshim mbrapsh për shkak të problemeve, mangësive apo pasaktësive të adresave të pronarëve të mjeteve në sistemin E-GJOBA. Gjithashtu ata na informuan se, që nga janari i vitit 2014 e në vazhdim njoftimet nuk ishin bërë për mungesë të fondeve për të blerë zarfa.

Ju sjellim në vëmendje nenin 199 të Kodit Rrugor i cili parashikon detyrimin e organit të policisë për njoftimin e shkeljes kundërvajtësit jo prezent. Në të njëjtën kohë kjo dispozitë ka parashikuar edhe mënyrën e njoftimit, si nëpërmjet policisë rrugore, korrierët komunalë, postës, etj. Gjithashtu Kodi Rrugor ka parashikuar edhe subjektin ndaj të cilit do të ngarkohen shpenzimet e verifikimit dhe të njoftimit në këto raste, i cili është kundërvajtësi. Mungesa e adresave të sakta të disa kundërvajtësve apo mungesa e fondeve për të blerë zarfa nuk justifikojnë dhe nuk legjitimojnë moskryerjen e detyrimit ligjor për të bërë njoftimin e përcaktuar në ligj.

Është me rëndësi të theksojmë se, në pikën 5 të nenit 199 të Kodit Rrugor është parashikuar edhe pasoja juridike për mosbërjen e njoftimit brenda periudhës kohore të përcaktuar në këtë ligj. Sipas kësaj dispozite, *subjekti (drejtuesi i mjetit që ka bërë shkeljen) njoftimi i të cilit nuk kryhet brenda periudhës kohore të përcaktuar (30 ditëve), nuk është më i detyruar të paguajë gjobën administrative.*

Për shkak të mosnjoftimit të drejtuesve (pronarëve) të mjeteve qindra gjoba të vendosuara në mungesë, shuma e të cilave shkon në disa miliona lekë, nuk mund të vilen në rrugë ligjore. Nëse organi dhe punonjësit e policisë do të vepronin konform ligjit me korrektësi dhe saktësi në plotësimin e adresave të kundërvajtësve do të mund të kontribuonin në vjeljen e gjobave dhe për rrjedhoj në rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Nga verifikimi rastësor i disa rasteve të njoftimeve dhe i procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve, të cilat ishin bërë gjatë vitit 2014, por që nuk ishin dërguar për arsyet e përshkruara më sipër rezultoi se, kishte pasaktësi të rëndësishme në të dhënat e pasqyruara në procesverbalin e konstatimit të shkeljes dhe për rrjedhoj edhe në shkresën e njoftimit për gjobën në mungesë me të dhënat e nxjera nga sistemi i administrimit elektronik të gjobave (E-GJOBA). Megjithëse bëhej fjalë për të njëjtin mjet e targë, nuk përputheshin gjeneralitetet e pranarit të mjetit si p.sh.; emri dhe mbiemri (njëherazi), emri apo mbiemri (më vete), vendbanimi i pranarit (qyteti), ose adresa e tij e plotë apo e saktë etj.

Nga pyetja e punonjësve të policisë që punonin në sallën e marjes dhe të dhënies së informacioneve dhe komunikonin me punonjësit e policisë që konstatonin mjetet në kundërvajtje pa qënë prezent drejtuesit e tyre u informuam se, pasaktësitë në këto dokumenta mund të kenë ardhur për shkak se në të njëjtën kohë mund t’u jetë dhënë informacion nëpërmjet radios disave prej kolegëve në teren dhe këta të fundit kanë pasqyruar të dhënat jo për mjetin që kanë konstatuar vetë, por ato të mjetit që kanë konstatuar të tjerët.

Ne mendojmë se, një mënyrë zgjidhjeje efektive për këtë problem mund të jetë plotësimi i të dhënave nga punonjësit e policisë konstatues në organin e policisë pasi të mbarojnë shërbimin dhe jo në teren duke i marë ato nëpërmjet radios.

Theksojmë se kohët e fundit, Shefi i Komisarjatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë ka nxjerë një urdhër me Nr. 3115/b Prot., datë 22.09.2014 “Mbi procedurat e konstatimit në mungesë të kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor”. Ne mendojmë se zbatimi i këtij urdhri nga efektivit i policisë rrugore do të ndikoj dukshëm në përmirësimin e situatës aktuale, si për disiplinimin e vendosjes së gjobave

në mungesë ndaj drejtuesve të mjeteve, ashtu edhe lidhur me detyrimin ligjor për njoftimin e tyre.

Sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët:

Gjatë kohës së inspektimit të kryer në këtë organ u monitorua edhe sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët e ndryshëm, të cilët kishin ardhur për probleme të ndryshme, si të marë informacione, për të bërë ankesa, kërkesa, për sqarime, etj. Nga monitorimi u konstatua se punonjësit e policisë komunikonin në mënyrë korrekte dhe me etikë me qytetarët e pranishëm. Kjo mënyrë sjelljeje rrit imazhin dhe prestigjin e Policisë së Shtetit në publik dhe ndërkohë edhe besimin e qytetarëve ndaj këtij organi të administratës publike.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

1. Rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë për gjetjen e rrugëve dhe mënyrave ligjore me qëllim për të bërë të mundur saktësimin e adresave të pronarëve të mjeteve.

2. Marrjen e masave të menjëhershme organizative për realizimin brenda afatit ligjor të njoftimit të drejtuesve të mjeteve ndaj të cilëve janë vendosur gjoba në mungesë për kryerjen e kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor.

3. Marrjen e masave të nevojshme teknike e organizative për të bërë të mundur nxjerjen nga sistemi E-GJOBA, transmetimin dhe pasqyrimin në procesverbalin e konstatimit të shkeljes e të dhënave të sakta lidhur me gjeneralitetet e pronarëve të mjeteve dhe të adresave të tyre të plota.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditorë, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI